



UNIVERSITETI  
**BARLETI**

**Miraturar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 64, datë 13/04/2021**

**Amended by Academic Senate Decision No. 40, dated 24/12/2025**

**FACULTY OF ECONOMICS, GOVERNMENT AND LAW**

## **RREGULLORE E FAKULTETIT TË EKONOMISË, QEVERISJES DHE DREJTËSISË**

**Tiranë 2025**





## KREU I ORGANIZIMI I FAKULTETIT

### Neni1

#### Baza Ligjore

Kjo Rregullore e Fakultetit bazohet në përcaktimet e legjislacionit për arsimin e lartë në fuqi, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Barleti” (në vijim **UniBa**) dhe e shtrin veprimin e saj mbi të gjitha njësitë përbërëse, personelin dhe studentët e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë.

### Neni 2

#### Struktura dhe Organet Drejtuese të Fakultetit

1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura dhe ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përfundim të të cilave lëshohen diplomat përkatëse.
2. Fakulteti Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (në vijim Fakulteti) përbëhet nga këto departamente:
  - a. Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës.
  - b. Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit.
  - c. Departamenti i Drejtësisë.
3. Autoriteti drejtues i Fakultetit është *Dekani*. Autoriteti drejtues i Departament-it është *Përgjegjësi i Departamentit*.
4. Organet kolegjiale drejtuese të Fakultetit janë: *Asambleja e personelit akademik të Fakultetit dhe Dekanati*.

### Neni3

#### Asambleja e Personelit Akademik të Fakultetit

1. Asambleja e personelit akademik të Fakultetit është organ kolegjial i Fakultetit i cili bazuar në nenin 22 të Statutit të **UniBa** ka këto detyra:
  - a) Zgjedh dy përfaqësues nga çdo njësi kryesore si anëtarë të Senatit Akademik;
  - b) Vendos për krijimin e komisioneve të përhershme të Fakultetit nëse janë të nevojshme dhe zgjedh anëtarët e tyre.
2. Asambleja e personelit akademik të Fakultetit njëkohësisht funksionin si një forum që diskuton dhe shqyrton çështje lidhur me procesin e mësimdhënies, kërkimit dhe kualifikimit.
3. Dekani thërret Asamblenë e Fakultetit në mbledhje të paktë një herë në 6 (gjashtë) muaj. Rendi i ditës zakonisht propozohet nga Dekani. Asambleja e përgjithshme e Fakultetit mund të mbledhet edhe në seancë të jashtëzakonshme me thirrjen e Dekanit, ose kur këtë e kërkon të paktën 1/3 e anëtarëve. Asambleja del me rekomandime drejtuar Dekanatis.



## Neni 4

### Dekanati

1. Dekanati është organ kolegjal i Fakultetit, i cili drejtohet nga Dekani dhe në përbërje të tij janë: Dekani, Zëvendësdekanët (nëse ka); Përgjegjësit e Departamenteve; një përfaqësues i studentëve të fakultetit përkatës, pa të drejtë vote. Në funksion të tematikës dhe trajtimit të problemeve, në mbledhjet e dekanatit mund të ftohen të marrin pjesë edhe koordinatorët e departamenteve, përfaqësuese të strukturave kërkimore-shkencore dhe aplikative, përfaqësues të strukturave në mbështetje të studentëve etj.
2. Dekanati ka këto detyra dhe kompetenca kryesore:
  - a) Koordinon dhe mbështet veprimtarinë akademike, kërkimore dhe administrative të Fakultetit;
  - b) Mbikëqyr dhe mbështet mësim dhënien në programet e ndryshme të studimit që mbulon Fakulteti;
  - c) Ndërmerr nismën dhe nxit veprimtarinë inovative lidhur me drejtimet e kërkimit shkencor të departamenteve;
  - d) Ndërmjetëson për lidhje marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme lidhur me praktikën e studentëve apo forma të tjera bashkëpunimi.
3. Dekanati zhvillon mbledhje të planifikuara nën drejtimin e Dekanit dhe me agjendë të përcaktuar prej tij. Me kërkesë të Dekanit ose të një prej anëtarëve të tij, Dekanati mund të zhvillojë edhe mbledhje të jashtëzakonshme.

## Neni 5

### Dekani

1. Dekani është autoriteti drejtues kryesor i Fakultetit që e përfaqëson atë si dhe anëtar i Rektoratit dhe Senatit Akademik.
2. Kandidati për dekan duhet të jetë personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të UniBa ose dhe jashtë tij.
3. Emërohet nga Rektori, pasi propozohet nga Administratori i Shoqërisë. Mandati i dekanit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë riemërimi vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
4. Dekani duhet të ketë kualifikim në përputhje me fushat e studimit që ofron Fakulteti dhe të ketë një eksperiencë të paktën 5 vjeçare në mësimdhënie dhe administrim në arsimin e lartë.
5. Fakulteti, në varësi të veprimtarisë, numrit të programeve të studimit, mund të caktojë zëvendës dekan. Zëvendës dekan propozohet nga dekan dhe emërohet nga rektori. Ai ndihmon dekanin në drejtimin e fakultetit dhe përgjigjet përpara tij dhe rektoratit për detyrat e ngarkuara. Dekani mban përgjegjësi dhe përgjigjet drejtpërsëdrejti përpara Rektorit dhe Senatit dhe bashkëpunon ngushtë me Zëvendësrektorët dhe Administratorin.



### Neni 6

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë e Dekanit

1. Krahas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuar gjerësisht në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e **UniBa**, Dekani ka edhe këto detyrat dhe përgjegjësi:
  - Ofron udhëheqje dhe kontribuon në proceset që lidhen me zhvillimin e Fakultetit si planifikimi strategjik dhe akademik, mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, zhvillimi i programeve, kurrikulës dhe akreditimin, promovimi i fakultetit, rekrutimi i studentëve të rinj etj.
  - Koordinon veprimtarinë e departamenteve;
  - Zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre;
  - I përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tyre.

### Neni 7

#### Departamentet

1. Departamentet janë njësitë bazë mësimore dhe kërkimore që realizojnë programe studimi të ngjashme dhe grupojnë disiplinat mësimore përkatëse.
2. Në Departamente përfshihet i gjithë personeli akademik përkatës. Organizimi dhe funksionimi i Departamenteve parashikohet në Rregulloret përkatëse të tyre.

### Neni 8

#### Përgjegjësi i departamentit

1. Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti drejtues më i lartë i Departamentit, i cili raporton dhe mban përgjegjësi përpara Dekanit. Ai është anëtar i Dekanatit.
2. Përgjegjësi i Departamentit duhet të jetë personel akademik i kategorisë “Profesor”, ose të ketë gradën “Doktor” (PhD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD ose BE. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie mund të kandidojë për këtë pozicion edhe lektori i cili mban gradën shkencore “Doktor”.
3. Përgjegjësi i Departamentit duhet të ketë kualifikim në përputhje me fushat e studimit të programeve që ofron Departamenti dhe të ketë eksperiencë të pasur në mësimdhënie dhe administrim në arsimin e lartë.
4. Përgjegjësi i Departamentit emërohet nga Rektori me propozim të Dekanit me mandat 4 (katër) vjeçar me të drejtë rizgjedhje,
5. Krahas detyrave si staf akademik, ai ka përgjegjësinë të mbikëqyrë funksionimin e përditshëm të punëve të departamentit dhe mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve që mbulon departamenti si dhe të krijojë marrëdhënie ndërlidhëse me aktorë dhe struktura nga tregu i punës.
6. Detyrat dhe përgjegjësitë e Përgjegjësit të Departamentit janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e **UniBa** dhe në Rregulloren e Departamentit.

### Neni 9



## Personeli i fakultetit

1. Personeli i Fakultetit përbëhet nga:
  - a) personeli akademik;
  - b) personeli ndihmës akademik;
  - c) personeli administrativ.
2. Personeli në Fakultetit mund të jetë i punësuar me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar. Ai mund të punësohet me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Personeli drejtues dhe personeli akademik i brendshëm është i punësuar me angazhim me kohë të plotë. Personeli akademik i jashtëm punësohet me angazhim me kohë të pjesshme.
3. Punësimi i personelit në Fakultetit bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për Arsimin e lartë dhe Kodin e Punës sipas procedurave të përcaktuara në manualin përkatës të Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

## KREU II

### CIKLET DHE FUSHAT E STUDIMEVE

#### Neni 10

#### Ciklet e studimeve

1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë ofron programe studimi me karakter profesional, programe në Ciklin e Parë dhe në Ciklin e Dytë, të studimeve, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe Statutin, pas miratimit të tyre nga ana e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të këtyre programeve, lëshohen certifikatat ose diplomatat përkatëse.
2. Studentët që aplikojnë për cikël të dytë studimi duhet të kenë përfunduar më parë studimet e ciklit të parë të një programi të licensuar dhe akredituar, në një IAL të licensuar dhe të akredituar brenda ose jashtë vendit.
3. Fakulteti, ofron programe të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës, si dhe ka të drejtë të ofrojë “Master ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
4. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”. Institucionet e arsimit të lartë vendosin kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor.
5. Studentët që aplikojnë për cikël të tretë studimi, duhet të kenë përfunduar më parë studimet e ciklit të parë dhe të dytë, master i shkencave të një programi të licensuar dhe akredituar, në një IAL të licensuar dhe të akredituar brenda ose jashtë vendit.
6. Kriteret specifike për pranimet në programet e ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në



rregulloren e programit të studimit përkatëse.

7. Fakulteti mund të bashkëpunojë me institucione të tjera vendase dhe të huaja të arsimit të lartë dhe të ofrojë programe studimi të përbashkëta ose të një modeli të ndryshëm nga ato të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe të bëra me dije publikut, kur diplomat lëshohen nga institucioni i huaj.

## Neni 11

### Fushat e studimeve

1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë ofron studime në fushën e Ekonomisë, Financës dhe Bankës, Menaxhimit, Qeverisjes, Drejtësisë, Marketingut dhe Publicitetit, Administrimit Publik, Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Europiane si dhe fusha të tjera të ngjashme ose të përafërta.
2. Lista e programeve të studimit aktive të ofruara nga Fakulteti i bashkëlidhet kësaj rregulloreje në formën e aneksit dhe përditësohet në çdo fillim viti akademik.

## Neni 12

### Programet e studimit dhe diplomat

1. Fakulteti ofron program me karakter profesional, me 120 kredite, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve me qëllim për të dhënë njohuri të konsoliduara profesionale dhe aftësi praktike përkatëse. Në përfundim të tij lëshohet “Certifikatë Profesionale” ose “Diplomë Profesionale” në fushën e arsimit të kryer.
2. Fakulteti ofron programet e studimit të ciklit të parë që japin njohuri bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe që realizohen me 180 kredite ECTS. Në përfundim të këtyre studimeve, studentit i lëshohet diplomë “Bachelor” në fushën e studimeve të kryera.
3. Fakulteti ofron programet e ciklit të dytë që përfshijnë programet e studimit “Master i Shkencave”, “Master Profesional” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.
  - a. Programet e Studimit “Master i Shkencave” japin njohuri të thelluara teorike dhe praktike dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë brenda një specialiteti. Ato realizohen në :
    - i. Programe me 120 kredite ECTS;
    - ii. Programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë me 300 kredite.Në përfundim të këtyre programeve të studimit, studentit i lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e studimeve të kryera.
  - b. Programet e studimit “Master Profesional” pjesë e studimeve të ciklit të dytë dhe i ofrojnë studentit arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Ato realizohen me 60 ose 120 kredite ECTS.
4. Fakulteti mbi bazën e licencimit dhe akreditimit, ka të drejtë të ofrojë programe të ciklit të tretë të studimeve të cilat përfshijnë programet e studimeve “Master Ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, programet e doktoratës.



### Neni 15

#### Kriteret e pranimit

1. Në programet e ofruara nga Fakulteti pranohen për të ndjekur studimet shtetas shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kriteret:
  - a) Vërtetojnë me dokument zyrtar (Diplomë) mbarimin e një shkolle të mesme publike ose jopublike brenda ose jashtë vendit (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë) për rastin e programeve të Ciklit të Parë; vërtetojnë me dokument zyrtar (Diplomë) mbarimin e studimeve të Ciklit të Parë në një IAL brenda ose jashtë vendit (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë), për rastin e programeve të Ciklit të Dytë.
  - b) Vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një shkollë universitare publike ose jopublike brenda ose jashtë vendit.
  - c) Pranojnë të paguajnë tarifën e studimeve.
2. Përveç kriterëve të mësipërme Fakulteti mund të miratojë kriterë specifike të cilat i gjykon të nevojshme për shkak të specifikave të programi, ose për të tërhequr studentë cilësorë.
3. Procedurat e regjistrimit bëhen në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë. Ato parashikohen dhe në rregulloren e fakultetit/dhe ose programit.
4. Studentët që regjistrohen për të ndjekur studime të plota në UniBa, matrikulohen sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin e arsimit të lartë dhe pajisen me kartën e studentit.
5. Numri i pranimeve në Fakultet mbështetet në mundësitë reale të fakultetit për një mësim normal, brenda standardeve të vendosura nga Ministria që mbulon arsimin e lartë.

### Neni 16

#### Dokumentet për regjistrim

1. Studentët që do të regjistrohen për herë të parë në **UniBa**, i nënshtrohen procedurës së regjistrimit sipas parashikimeve të legjislacionit të arsimit të lartë.
2. Në rregulloren e programit parashikohen dokumentet përkatëse të regjistrimit në përputhje me politikat e Fakultetit dhe specifikat e programit të studimit.

### Neni 13

#### Afati i studimeve

1. Studimet e plota universitare në Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë ndiqen me kohë të plotë. Gjithashtu parashikohen edhe programe të studimeve të formimit të vazhduar, formime afatshkurtëra si kualifikime profesionale dhe specializime të ndryshme.
2. Studimet organizohen në vite akademike; viti akademik ka dy semestra, kohëzgjatja e semestrit është 15 javë kalendarike.
3. Programet e studimit me karakter profesional, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të





Kualifikimeve, zgjasin, si rregull, dy vite akademike. Studimet universitare të Ciklit të Parë zgjasin, si rregull, tre vite akademike. Studimet universitare të Ciklit të Dytë zgjasin, si rregull, një ose dy vite akademike; Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë këto studime zgjasin pesë ose gjashtë vite akademike në varësi të fushës; studimet e Ciklit të tretë “master ekzekutiv si rregull zgjasin një ose dy vite akademike, ndërsa programet e doktoratës zgjasin si rregull, jo më pak se tre vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike.

4. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.
5. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren lidhur me transferimet.
6. Studenti lejohet të regjistrohet në vitin pasardhës kur ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të viteve paraardhës. Lëndët të cilave u përkasim kreditet e mbetura konsiderohen detyrime të mbartura. Kushtet dhe rendin e shlyerjes së detyrimeve të mbartura për fitimin e krediteve të mbetura i cakton Departamenti i cili e ofron programin e studimit.

## Neni 14

### Diplomimi

1. Studimet e programeve me karakter profesional, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, konsiderohen të përfunduara pas përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në planin mësimor përkatës.
2. Studentët e ciklit të parë të studimeve, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome. Pragu i notës mesatare që i jep studentit të drejtën të për t'u diplomuar duke përgatitur dhe mbrojtur një temë diplome, është 9.5.
3. Studimet e ciklit të dytë “Master Profesional” përmbyllen me një provim përfundimtar formimi.
4. Studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” përmbyllen me një punim diplome. Këtu përfshihet edhe Master i shkencave (program i integruar).
5. Afati maksimal i realizimit të provimit përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës është në përputhje me kohëzgjatjen maksimale të parashikuar sipas programit/ciklit të studimeve. Brenda këtij afati studenti ka të drejtë të riprovohet për mbrojtje në sezonet e provimeve të përcaktuara sipas kalendarit akademik.
6. Në rastet kur studimet përmbyllen me provim të përgjithshëm përfundimtar Departamenti që ofron programin përgatit programin orientues për studentët.
7. Procedurat, afatet, dokumentacioni dhe detyrimet e lidhura me provimin përmbyllës përfundimtar ose punimin e diplomës parashikohen në rregulloren e programit dhe/ose në





programin e provës finale.

## Neni17

### Dispozita të fundit

1. Rregullorja e Fakultetit miratohet nga Senati i Universiteti “Barleti” dhe hyn në fuqi menjëherë.
2. Kjo Rregullore ka fuqi vepruese mbi të gjitha njësitë përbërëse të Fakultet-it.
3. Kompetenca për interpretimin e rregullores i përket Senatit





## ANEKS 1

### PROGRAMET E STUDIMIT AKTIVE TË VITIT AKADEMIK 2020-2021

#### FAKULTETI I EKONOMISË, QEVERISJES DHE DREJTËSISË

##### DEPARTAMENTI I EKONOMISË, SIPËRMARRJES DHE FINANCËS

1. Program Profesional (2 vjeçar) - Teknik në Operacioni Biznesi, Marketing dhe Shitje.
2. Bachelor në Financë. Bankë dhe Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme.
3. Bachelor në Financë Kontabilitet.
4. Bachelor në Marketing, Publicitet dhe Marrëdhënie me Publikun.
5. Bachelor në Menaxhim Biznesi.
6. Master Profesional në Administrim Biznesi me profil Financë Kontabilitet.
7. Master Profesional në Administrim Biznesi me profil Liderhip dhe Menaxhim i Burimeve Njerëzore.
8. Master Profesional në Administrim Biznesi me profil Marketing dhe Menaxhim Operacionesh.
9. Master Shkencor në Kontabilitet-Financë me profil Kontabilitet.

##### DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

1. Program i Integruar Master Shkencor në: Drejtësi (300 Ects).
2. Master Profesional në: Shkenca juridike me profil E Drejtë Biznesi.
3. Master Shkencor në: Shkenca juridike me profil E Drejtë Tregtare.
4. Master Shkencor në: Shkenca juridike me profil E Drejtë Penale dhe Kriminologji.

##### DEPARTAMENTI I QEVERISJES SHKENCAVE POLITIKE DHE KOMUNIKIMIT

1. Bachelor në: Shkenca Politike.
2. Master profesional në: Shkenca Politike me profil Administrim Publik.
3. Master Shkencor në: Studime Europiane me profil Politika Europiane dhe Administrim Publik

#### PËR SENATIN E UNIVERSITETIT "BARLETI"

Kryetari

Prof. Dr. Suzana Guxholli

*Suzana Guxholli*